



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 702/2 prot.

Tiranë, më 24/08/2021

### V E N D I M

**Nr. 159, datë 24/08/ 2021**

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (në vijim Komisioneri), mori në shqyrtim ankesën nr. 25, datë 23.02.2021, të paraqitur nga A.Sh, përfaqësuar me prokurë të posaçme K.Sh, ku pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë (në vijim DRAP Lezhë) dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër (në vijim ZVAP Shkodër).

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Ankuesi është me profesion mësues në profilin “*edukim fizik*”. Ai ka konkuruar në portalin “Mësues për Shqipërinë” për Zyrën Vendore Arsimore Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, në profilin “*edukim fizik*”, por nuk i është ofruar asnjë vend pune.

Në lidhje me këtë fakt ai është ankuar pranë DPAP dhe DRAP Lezhë, por nuk ka marrë asnjë përgjigje shteruese dhe sqaruese për ankesat që ka paraqitur, lidhur me faktin që mësues të ndryshëm janë emëruar pa patur ngarkesa të plota në profilin e tyre, ndërkohë që në shkolla orët e edukimit fizik nuk jepen nga mësues të diplomuar në këtë profil.

Ankuesi shpjegon se, është renditur i 5-ti në Portal në vitin 2019, pastaj pikët mbarten dhe në renditjet e tjera vit pas viti. Prej këtij momenti ka patur vende vakante, por ai nuk është emëruar

në asnjë prej këtyre vendeve. Sipas ankuesit vendet vakante shpesh herë nuk publikohen dhe nuk realizohen emërimet sipas renditjes në Portal.

Ankuesi pretendon se nuk emërohet sipas ligjit në vendet vakante, për shkak të bindjeve të tij politike, pasi ai është anëtar i Partisë Demokratike. Ankuesi deklaroi se babai i tij shtetasi K.Sh, anëtar i Partisë Demokratike, ka mbajtur dhe mban poste të ndryshme në këtë parti në qytetin e Shkodrës, si dhe është një figurë që njihet publikisht si përkrahës i Partisë Demokratike.

Sa më sipër, ankuesi kërkon nga Komisioneri, të ndaloj situatën diskriminuese dhe të urdhërojë emërimin e tij në vendin e punës sipas legjislacionit në fuqi.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Në nenin 12/1/a/b) të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; .....*”.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.363/1 prot datë 05.03.2021, Komisioneri njoftoi dhe kërkoi informacion nga DRAP Lezhë dhe ZVAP Shkodër, lidhur me pretendimet e ankuesit.

1.1 Në përgjigje të kësaj kërkesë **ZVAP Shkodër**, me anë të shkresës nr. 517/1 prot., datë 18.03.2021<sup>1</sup>, ka dërguar parashtrimet në lidhje me ankesën duke sqaruar ndër të tjera se:

ZVAP Shkodër është e depozituar dhe bindjet politike nuk janë kriter për punësimin e mësuesve. Në çdo rast ZVAP Shkodër zbaton udhëzimin e MARS nr.13, datë 22.05.2019 “*Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e Portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar. (në vijim Udhëzimi i MASR nr.13/2019)*”

K.Sh, babai i A.Sh, ka depozituar disa herë kërkesa në ZVAP Shkodër dhe ka marrë përgjigje.

Me kredencialet e Portalit 2019-2020, janë punësuar 4 kandidat me kontratë pa afat dhe 13 kandidatë me kontratë me afat, sipas renditjes, lehtësisht të verifikueshme në Portalin “Mësues për Shqipërinë”. A. Sh është renditur i 5-ti dhe është punësuar me kontratë me afat në shkollën “Jordan Misja”, për vitin shkollor 2019-2020. Ndërsa me kredencialet e Portalit 2020-2021, janë punësuar dy kandidatë me kontratë me afat, sipas renditjes, lehtësisht e verifikueshme në Portalin “Mësues për Shqipërinë”

Më datë 09.12.2020, ZVAP Shkodër ka bërë shpalljen për vend pune në shkollën “9-Shtatori”, Nj.Administrative Topojan, shpallje dërguar nga DRAP Lezhë, bazuar në udhëzimin e mësipërm dhe A.Sh nuk ka kthyer përgjigje brenda 24 orëve siç parashikohet në kreun 4, pika 5, të udhëzimit dhe ZVAP Shkodër ka vazhduar procedurën e udhëzimit.

Më datë 15.12.2020, ZVAP Shkodër ka bërë shpalljen për vend pune në shkollën “Haxhi Hajdari”, Nj.Administrative Rrethina. A.Sh nuk ka kthyer përgjigje brenda 24 orëve, siç parashikohet në kreun 4, pika 5 të udhëzimit dhe ZVAP Shkodër ka vazhduar me procedurën e udhëzimit.

Më datë 08.01.2021, ZVAP Shkodër, ka bërë shpalljen për vend pune në shkollën “1 Qershori” dhe “Havzi Nela”, Kukës, shpallje dërguar nga DRAP Lezhë, bazuar në udhëzimin e mësipërm dhe A.Sh nuk ka kthyer përgjigje brenda 24 orëve, siç parashikohet në kreun 4, pika 5 të udhëzimit dhe ZVAP Shkodër ka vazhduar me procedurën e udhëzimit.

Më datë 24.02.2021, drejtori i institucionit arsimor “Qazim Mehja” ka depozituar në sekretarinë e ZVAP Shkodër kërkesë për personel mësues për profilin fizik. Komisioni i ZVAP Shkodër ka zhvilluar procedurën e parashikuar në udhëzimin e MARS nr.13, datë 22.05.2019, i ndryshuar, për punësimin në këtë profil dhe është emëruar kandidat i renditur i pari I.G.

Pra, A.Sh i janë ofruar vende pune në institucionet arsimore të ndryshme të cilat ai i ka refuzuar.

---

<sup>1</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 363/2 prot., datë 23.03.2021.

ZVAP Shkodër deklaron se, në juridiksionin e ZVAP Shkodër nuk ka vende të lira pune në profilin edukim fizik.

1.1 1.2 Në përgjigje të kësaj kërkesë **DRAP Lezhë**, me anë të shkresës nr. 371/1 prot., datë 12.04.2021<sup>2</sup>, ka dërguar parashtrimet në lidhje me ankesën duke sqaruar ndër të tjera se:

Ankuesi, është kandidat i portalit “Mësues për Shqipërinë”, viti 2020, profili edukim fizik, i renditur në vend të dytë të klasifikimit. Ai ka kërkuar punësimin e tij si mësues i edukimit fizik në institucionet arsimore në juridiksion të ZVAP Shkodër.

Procedurat e punësimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar kryhen bazuar në dispozitat e *Udhëzimit të MASR nr.13/2019* dhe Udhëzimit të MASR nr. 30, datë 12.09.2018 “*Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar*”.(në vijim Udhëzimi i MASR nr.30/2018). Këto akte të sipërcituara kanë të përcaktuara saktësisht procedurën dhe kompetencat e secilit institucion në emërimin e mësuesve.

*Së pari: Lëvizja paralele e mësuesve brenda sistemit me dëshirë ose për shkak të mungesës së ngarkesës mësimore:*

Bazuar në udhëzimin nr.13/2019, Kreu 1, pika 7: Vendet e lira të punës shpallen pasi është bërë plotësimi i kërkesave për lëvizje paralele dhe sistemimi i mësuesve që mbeten pa ngarkesë mësimore në zyrat vendore të arsimit parauniversitar, jo më vonë se 1 muaj para fillimit të vitit mësimor.

Për vitin shkollor 2020-2021, lëvizja paralele në ZVAP Shkodër është zhvilluar më datë 11.08.2020.

Një kandidat i profilit të edukimit fizik, ka kryer lëvizje paralele me dëshirë, nga shkolla 9-vjeçare “Branko Kadia” në Gjimnazin “Oso Kuka”. Shkolla 9-vjeçare “Branko Kadia”, me shkresën nr. 311 prot., datë 12.08.2020 “*Informacion për numrin e orëve për mësuesit e edukimit fizik dhe argumentet për mosshpalljen e vendit vakant*”, drejtuar ZVAP Shkodër, ka dërguar orët e lira të edukimit fizik pranë kësaj zyre dhe ka paraqitur argumentat për mosshpalljen e këtyre orëve pas lëvizjes paralele.

*Së dyti: Punësimi i mësuesve të Portalit “Mësues për Shqipërinë”.*

Procedura e punësimit të kandidatëve të Portalit “Mësues për Shqipërinë”, është:

- ZVAP për një vend të lirë pune, njofton kandidatët përmes postës elektronike, të cilën kandidati e ka deklaruar gjatë aplikimit *online* dhe me dosje;

---

<sup>2</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 363/5 prot., datë 16.04.2021.

- Kandidati, i cili në renditjen e përgjithshme është renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendin e lirë të punës dhe është i detyruar të konfirmojë në ZVAP brenda 24 orëve, nëpërmjet adresës elektronike. Në rast të moskonfirmimit nga kandidati, ky pozicion pune i ofrohet kandidatit të listuar një rend më poshtë. Midis kandidatëve që rezultojnë me pikë të barabarta, përparësi ka kandidati që mund të jetë në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara. Në rast se nuk ka persona me aftësi të kufizuara, vendi i lirë i ofrohet kandidatit që ka rezultatin më të lartë në testim.
- Kandidati fitues, paraqitet në institucionin arsimor ku ofrohet vendi i lirë i punës menjëherë sapo merr njoftimin. Ai i dorëzon drejtorit të institucionit dokumentin vërtetues, të printuar nga sistemi i aplikimit *online*, në Portalin “Mësues për Shqipërinë”.
- Kandidati punësohet nga drejtori i institucionit arsimor me kontratë pune individuale, me ose pa afat, sipas kërkesave të vendit të lirë të punës.

Ankuesi, ka drejtuar ankesë në Platformën e Bashkëqeverisjes, për mos punësimin në institucionet arsimore në juridiksion të ZVAP Shkodër. Pretendimet e ankuesit kanë qenë se, në drejtoritë e institucioneve arsimore nuk shpallin vende vakante të profilit. Për ankesën e tij, Sekretari i Përgjithshëm i MASR, ka dërguar shkresën nr. 68/1 prot., datë 13.01.2021 “*Për shqyrtimin e ankesës së K.Sh*”. Bazuar në këtë shkresë, me urdhrin nr. 37, datë 26.01.2021, të drejtorit të DRAP Lezhë, është ngritur grupi i inspektimit për verifikimin e ankesave të z.B.V dhe K.Sh.

Grupi i inspektimit më datë 26.01.2021 ka zhvilluar inspektimin në ZVAP Shkodër. Më datë 11.02.2021, grupi ka dorëzuar relacionin mbi inspektimin e zhvilluar. Sipas këtij relacioni, grupi i inspektimit është paraqitur pranë ZVAP Shkodër, por nuk ka zhvilluar inspektim bazuar ankesave të deleguara nga MASR, me motivacionin se, relacionet e DRAP Lezhë me nr. 2177/1 prot., datë 27.11.2020 dhe relacionet nr. 2282 prot., datë 09.12.2020, për verifikimin e ankesës së z.I. G, kandidat Portali, i profilit edukim fizik, në ZVAP Shkodër, janë të vlefshme edhe për ankesat e shtetasve B.V dhe K.Sh.

DRAP Lezhë, me shkresën nr. 265 prot., datë 15.01.2021 “*Dërgim relacioni*” drejtuar MASR dhe ZVAP Shkodër, ka përfunduar shqyrtimin e ankesave të kandidatëve të edukimit fizik, në ZVAP Shkodër dhe ka kërkuar nga ana e këtij të fundit dhe drejtorive të institucioneve arsimore në juridiksion të saj, marrjen e masave për zbatimin e tyre. Veprimtaria administrative e ndjekur nga DRAP Lezhë për verifikimin e ankesave të kandidatëve të profilit edukim fizik për punësim në institucionet arsimore në juridiksionin e ZVAP Shkodër, është:

DRAP Lezhë ka kërkuar informacion nga ZVAP Shkodër, mbi të gjitha ngarkesat mësimore të profilit edukim fizik, të institucioneve arsimore të kësaj zyre. Bazuar në shkresën e ZVAP Shkodër nr. 2185 prot., datë 16.11.2020 “*Mbi ngarkesën mësimore në lëndën edukim fizik për*

*shkollat 9-vjeçare dhe të mesme*”, institucionet arsimore të kësaj zyre nuk kanë paraqitur orë të lira të profilit edukim fizik.

DRAP Lezhë ka dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (*në vijim DPAP*) relacionin nr. 2177/1 prot., datë 27.11.2020, mbi një inspektim të zhvilluar në shkollën 9-vjeçare “Branko Kadia”, me konkluzionet si më poshtë:

1. Shkolla “Branko Kadia” bazuar në udhëzimin nr. 13, datë 22.05.2019, të dërgojë në ZVAP Shkodër, njoftimin për shpalljen e 16 orëve të lira të lëndës edukim fizik.
2. Shkolla 9-vjeçare “Branko Kadia”, të rishikojë shpërndarjen e ngarkesës mësimore të mësuesve sipas udhëzimit nr.30, datë 12.09.2018.

Në vijim të rekomandimeve të mësipërme, shkolla “Branko Kadia” ka dërguar në DRAP Lezhë, shkresën nr. 226 datë 22.01.2021 “*Kthim përgjigje relacioni*”, duke sqaruar se, për vitin shkollor 2020-2021, në kushtet e pandemisë, nuk ka orë në lëndën e edukimit fizik. Ishte kjo arsyeja se pse nuk kishte patur emërim të ri në profilin edukim fizik.

DRAP Lezhë, sqaron se, shkolla është institucioni përgjegjës, i cili menaxhon ngarkesën mësimore të shkollës dhe shpalljen e vendeve të lira të punës, me ose pa afat.

DRAP Lezhë ka zhvilluar inspektim në shkollat 9-vjeçare “Salo Halili”, “Ndre Mjeda” dhe “Azem Hajdari”, për të verifikuar ngarkesat e mësuesve të edukimit fizik në shkollë dhe orë të lira të këtij profili. Me relacionin nr. 2282 prot., datë 09.12.2020, DRAP Lezhë ka dërguar në DPAP dhe ZVAP Shkodër gjetjet e grupit të inspektimit, të cilat konsistojnë si më poshtë:

1. Institucioni arsimor “Salo Halili”, ka 18 klasa gjithsej, ku 10 klasa janë AF dhe 8 klasa janë AMU. U konstatua se dy mësuesit definitivë të profilit edukim fizik kanë përkatësisht 24 dhe 25 orë mësimore në javë secili, ose +2 dhe +3 orë mbi normën e tyre. Ndërsa 9 orë të tjera të profilit të edukimit fizik, i’u ishin shpërndarë mësuesve në shkollë për të plotësuar ngarkesën mësimore, megjithëse nuk ishin profil i përafërt, siç citohet në udhëzimin nr. 30 datë 12.08.2018, kreu V, “Të përgjithshme”, pika 1;
2. Institucioni arsimor “Ndre Mjeda”, ka 36 klasa gjithsej, ku 20 klasa janë në AF dhe 16 klasa janë në AMU. U konstatua se, 5 mësuesit definitiv të profilit edukim fizik kishin përkatësisht 22, 21, 24, 22, 22 orë mësimore. Ndërkohë u konstatua se, numri i nxënësve në paralelet e klasave të I është 87 nxënës, kl. II është 97 nxënës, kl. III është 92 nxënës, kl. IV është 89 nxënës, kl. VI është 97 nxënës dhe kl. IX është 94 nxënës të ndarë në 4 klasa, gjë e cila është në kundërshtim me udhëzimin nr. 30/2018, Kreu II/A, pika 2/b. Sipas drejtoreshës së shkollës, kjo situatë ishte vetëm për vitin respektiv si pasojë e pandemisë, pasi klasat nuk kanë hapësirë të mjaftueshme për të ruajtur distancën midis nxënësve nga njëri tjetri. Sipas drejtoreshës së shkollës, një gjë e tillë ishte bërë me miratimin e DRAP Lezhë vetëm për vitin

shkollor në kushtet e pandemisë. Si rezultat me 3 orët e profilit të edukimit fizik të shtuara në këtë situatë plotëson normën mësimore mësuesi i TIK, megjithëse nuk janë profil i përafërt, siç citohet në udhëzimin nr. 30/2018, kreu V, pika1.

3. Institucioni arsimor “Azem Hajdari”, ka 16 klasa gjithsej, ku 8 klasa janë në AF dhe 8 klasa janë AMU. U konstatua se 2 mësuesit definitiv të profilit të edukim fizik kanë përkatësisht nga 22 orë secili.

Në përgjigje të relacionit të mësipërm, shkolla 9-vjeçare “Salo Halili”, me nr. 510 prot., datë 21.01.2021, është shprehur se, ky institucion nuk kishte shpallur orët e lira sipas rekomandimit të DRAP Lezhë.

DRAP Lezhë parashtron se, pretendimi i ankuesit për mospunësimin e tij në institucionet arsimore të ZVAP Shkodër, për shkak të diskriminimit për bindje politike, është i pabazuar dhe në asnjë moment i justifikueshëm.

Në DRAP Lezhë, për vitin arsimor 2020-2021, ZVAP Shkodër ka shpallur një vend të lirë pune me afat në shkollën 9-vjeçare “Qazim Mehja”. Ky vend pune është pranuar nga kandidati i cili renditet i pari në Portal.

2. Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës Komisioneri me shkresën nr. 702 prot., datë 30.04.2021, njoftoi zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 12.05.2021.

Seanca dëgjimore, u zhvillua në datën 12.05.2021, me praninë e palëve: ankuesit, i cili u përfaqësua nga K.Sh, i pajisur me prokurë të posaçme nr. 2310 rep dhe nr. 565 kol, datë 11.05.2021, hartuar përpara noteres L. H., anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterisë, Zyra Vendore Shkodër; DRAP Lezhë, përfaqësuar nga N. M, sipas autorizimit nr. 633 prot., datë 11.05.2021, lëshuar nga Drejtori i DRAP Lezhë dhe ZVAP Shkodër, përfaqësuar nga M.T, sipas autorizimit nr. 959 prot., datë 10.05.2021, lëshuar nga Drejtori i ZVAP Shkodër.

3. Në vijim të seancës dëgjimore, përfaqësuesi i ankuesit ka depozituar dokumentacione shtesë në lidhje me ankesën, i cili u administrua me nr. 701/1prot., datë 18.05.2021.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.**



Bazuar në informacionin dhe provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se, ankuesi A.Sh, ka qenë kandidat i portalit “Mësues për Shqipërinë”, për vitin 2019-2020, në profilin Edukim Fizik dhe është renditur në vendin e 5-të të klasifikimit. Në vijim gjatë këtij viti mësimor ankuesi ka qenë i punësuar gjatë gjithë vitit si mësues i profilit të edukimit fizik, në shkollën Jordan Misja, me kontratë me afat.

Rezultoi se, ankuesi ka marrë pjesë si kandidat në Portalin “Mësues për Shqipërinë” për vitin 2020-2021 duke u renditur i 2-ti. Në vijim, ankuesit i janë ofruar disa vende pune, por nuk i ka pranuar. Ankuesi parashtrroi se i ka refuzuar këto vende, pasi ishin provizore, ndërkohë që sipas tij në shkollat në juridiksionin e ZVAP Shkodrës kishte orë të lira për ta emëruar atë në një vend pune definitiv dhe se dy prej vendeve që i ishin ofruar ishin në Kukës, ndërkohë që ai nuk kishte bërë kërkesë për punësim për në këtë qytet.

Në lidhje me pretendimet e tij ankuesi, ka paraqitur ankesa pranë DRAP Lezhë dhe MASR.

Ankuesi pretendon se me veprimet dhe mosveprimet e tyre, ZVAP Shkodër dhe DRAP Lezhë e kanë diskriminuar për shkak të bindjeve politike, duke mos e emëruar si mësues në profilin e edukimit fizik, sipas ligjit.

### **Legjislacioni i zbatueshëm**

Në nenin 60, të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se: “1. Në institucionin arsimor publik, përfshirë dhe atë parashkollor, pranimi dhe emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor. Emërimi i mësuesit bëhet nga drejtori i institucionit arsimor, sipas renditjes në portalin “Mësues për Shqipërinë”. Procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune, si dhe administrimi i portalit “Mësues për Shqipërinë” përcaktohen me udhëzim të ministrit...”

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është miratuar Udhëzimi i MASR-së nr. 13, datë 22.05.2019 “Për procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’”, i ndryshuar, Procedurat e punësimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar kryhen bazuar në dispozitat e këtij udhëzimi.

Në Kreun 1, pika 7, të udhëzimit nr.13/2009, të ndryshuar, parashikohet: “Vendet e lira të punës shpallen pasi është bërë plotësimi i kërkesave për lëvizje paralele dhe sistemimi i mësuesve që



*mbeten pa ngarkesë mësimore në zyrat vendore të arsimit parauniversitar (në vazhdim ZVAP) deri në 1 (një) ditë para fillimit të vitit mësimor.”*

Në Kreu I, pika 10, të udhëzimit nr.13/2009, të ndryshuar, parashikohet: *“DRAP dhe institucionet e varësisë kanë detyrimin të bëjnë publike vendet e lira të punës, në portalin “Mësues për Shqipërinë”, në faqen zyrtare të tyre dhe në standat e informimit publik.”*

Ndërsa në Kreun 4, pikat 4, 5, 7, 9 dhe 14 të Udhëzimit të sipërcituar, parashikohet:

*“4. Për një vend të lirë pune, kandidati njoftohet nga ZVAP përmes postës elektronike, të cilën kandidati e ka deklaruar gjatë aplikimit online dhe me dosje.*

*5. Kandidati, i cili në renditjen e përgjithshme është renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendin e lirë të punës dhe është i detyruar të konfirmojë në ZVAP brenda 24 orëve nëpërmjet adresës elektronike. Në rast të moskonfirmimit nga kandidati, ky pozicion pune i ofrohet kandidatit të listuar një rend më poshtë. Midis kandidatëve që rezultojnë me pikë të barabarta, përparësi ka kandidati që mund të jetë në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara. Në rast se nuk ka persona me aftësi të kufizuara, vendi i lirë i punës i ofrohet kandidatit që ka rezultatin më të lartë në testim.*

*6. ...*

*7. Kandidati fitues paraqitet në institucionin arsimor ku ofrohet vendi i lirë i punës menjëherë sapo merr njoftimin. Ai i dorëzon drejtorit të institucionit dokumentin vërtetues, të printuar nga sistemi i aplikimit online, në portalin “Mësues për Shqipërinë.*

*8. ...*

*9. Kandidati punësohet nga drejtori i institucionit arsimor me kontratë pune individuale, me ose pa afat, sipas kërkesave të vendit të lirë të punës.*

.....

*14. Në rast refuzimi të kandidatit fitues për vendin e lirë të propozuar, kandidati vazhdon të qëndrojë në renditje dhe atij i ofrohen vende pune të tjera të lira, deri në procedurat e hapjes së portalit të ri “Mësues për Shqipërinë”...” Udhëzimi Nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, në pikën III/D, parashikon se normat mësimore javore e mësuesve dhe përcakton se: “...3. Mësuesi i gjuhës shqipe, i gjuhës së huaj, i matematikës, i fizikës, i biologjisë, i kimisë, i informatikës, i historisë, i gjeografisë, mësuesi në shkollat e arsimit special: 20 orë në javë. 4. Mësuesi i lëndëve të tjera: 22 orë në javë...”. Sipas këtij Udhëzimi e njëjta normë mësimore vlen për mësuesit e Arsimit Bazë dhe atij të Mesëm të Lartë/Gjimnazit.*

Ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën e tij për t’u punësuar si mësues i edukimit fizik në një nga institucionet arsimore nën juridiksionin e ZVAP Shkodër, ku edhe ka bërë kërkesën e tij për punësim, që me Portalin “Mësues për Shqipërinë” të vitit 2019-2020.

Rezultoi e provuar se gjatë vitit mësimor 2019-2020, gjatë të cilit gjen zbatim Portali “Mësues për Shqipërinë” 2019-2020, ankuesi ka qenë i punësuar pranë Shkollës “Jordan Misja”. Rezultoi se, me kredencialet e Portalit të këtij viti mësimor ishin punësuar me kontratë me afat të pacaktuar 4 kandidatët e Portalit. ZVAP Shkodër prapësoi gjatë shqyrtimit të ankesës se për këtë vit mësimor nuk ka patur vende të tjera vakante për mësues të profilit të edukimit fizik, të cilat plotësonin kushtet për të punësuar kandidatin e radhës i renditur i 5-ti në portalin e këtij viti, që korrespondon me ankuesin A.Sh. Sipas ZVAP Shkodër, e drejta e ankuesit nuk ishte cënuar pasi ajo kishte respektuar renditjen e kandidatëve në portal dhe se ankuesi ka qenë i punësuar me kontratë me afat, pra nuk i është mohuar e drejta për të punuar.

Përfaqësuesi i ankuesit, gjatë seancës dëgjimore parashtrori se, ZVAP Shkodër ka kryer paligjshmëri në lidhje emërimin, levizjen, ngarkesat apo orët e lira në lidhje me profilin e edukimit fizik, që prej portalit 2016-2017. Përfaqësuesi ankuesit pretendoi se, me Portalin e 2019-2020, ankuesi duhet të ishte emëruar në shkollën “Salo Halili” pas largimit jashtë shtetit të mësuesit të edukimit fizik në këtë shkollë, i cili kishte 22 orë mësimore, por edhe në shkollën “Preng Jakova”, pas daljes në pension të mësuesit të edukimit fizik në këtë shkollë, i cili kishte 18 orë në këtë shkollë dhe 4 orë në shkollën “Shejnaze Juka”, por në këtë pozicion emërohet A.R, i cili ishte emëruar në mënyrë të paligjshme nga portalet e mëparshme. Po gjatë Portalit 2019-2020, sipas përfaqësuesit të ankuesit, ky i fundit ka patur mundësi për t’u emëruar në shkollën “Oso Kuka”, kur mësuesja e edukimit fizik doli në pension, por në mënyrë të paligjshme përfaqësuesi i ankuesit shprehet se kjo mësuese vazhdoi punën deri në fund të vitit shkollor. Përfaqësuesi pretendoi se, paligjshmëritë në emërimet e mësuesve dhe mosshpallja e vendeve të lira të punës, kanë cënuar të drejtën e djalit të tij për t’u punësuar.

Pretendimi i ankuesit për cënimin e të drejtës së tij për t’u emëruar si mësues në përputhje me ligjin, konsiston pikërisht në faktin se, sipas tij ka patur mundësi që ai të ishte emëruar si mësues definitiv, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe atij i janë ofruar vetëm vende provizore. Pra, kanë qenë një zinxhir veprimesh dhe mosveprimesh të paligjshme, në kohë të ndryshme, të cilat sipas përfaqësuesit të ankuesit, janë kryer për shkak të bindjeve politike të ankuesit dhe të atij vetë si babai i tij, me qëllim mos emërimin e ankuesit si mësues definitiv.

Bazuar në aktet e administruara rezulton se pas ankesave të depozituara nga përfaqësuesi i ankuesit pranë DRAP Lezhë, me shkresën nr. 181/1 prot., datë 10.02.2020, ZVAP Shkodër, ka dhënë sqarime për pretendimet në shkollën “Salo Halili”, duke parashtruar se: *“Në shkollën 9-vjeçare “Salo Halili” mësuesi F.S ka marrë leje pa të drejtë page dhe orët e tij realizohen nga mësuesja e edukimit fizik E.P, e cila ka plotësuar normën në shkollën Oso Kuka me 14 orë, orë të cilat i ka patur në normë mësuesi N.H (i cili ka qenë i pezulluar), por është rikthyer në punë. Në dhjetor kjo mësuese e ka patur normën e reduktuar.”*

Për sa i përket situatës gjatë vitit shkollor 2019-2020 në shkollën “Oso Kuka”, gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesja e ZVAP Shkodër sqaroi se, mësuesja e edukimit fizik, sikundër të gjithë mësuesit e tjerë në të njëjtat kushte me të, të cilët kishin mbushur moshën e pensionit, bazuar në udhëzimet e përcjella nga DRAP Lezhë në situatën e pandemisë, kanë vazhduar të punojnë deri në fund të vitit shkollor. Vendi i mbajtur nga kjo mësuese ishte shpallur më vonë i lirë dhe për këtë pozicion ishin zhvilluar procedurat e lëvizjes paralele në muajin gusht 2020.

Në lidhje me rastin e shkollës “Preng Jakova”, rezultoi se ky vend ishte plotësuar me mësuesin A.R, i cili ishte definitiv. Përfaqësuesi i ankuesit pretendoi se, ky mësues ishte bërë definitiv në bazë të portaleve të mëparshme në kundërshtim me ligjin dhe për këtë arsye emërimi i tij në këtë shkollë kishte cënuar të drejtën e ankuesit për t’u emëruar në këtë pozicion pune si definitiv.

Rezultoi se ankuesi ka marrë pjesë në Portalin “Mësues për Shqipërinë” për vitin 2020-2021, duke u renditur i 2-ti. Ankuesi pretendoi se nuk i është ofruar asnjë vend pune në profilin e edukimit fizik, duke pretenduar se në institucionet arsimore në juridiksionin e ZVAP Shkodër ka orë të lirë në këtë profil, por nuk shpallen. ZVAP Shkodër prapësoi duke pretenduar se ankuesit i ishin ofruar vende pune, të cilat i kishte pranuar. Në lidhje me këtë pretendim të ZVAP Shkodër, përfaqësuesi i ankuesit u shpreh se, refuzimi i vendeve ishte bërë pasi ato ishin provizore, në zona të largëta dhe në institucione arsimore në juridiksionin e ZVAP Kukës, për të cilën ai nuk kishte bërë kërkesë. Përfaqësuesi i ankuesit pretendoi se ka orë të lira në shumë në institucionet arsimore në ZVAP Shkodër, që mundësonin emërimin e tij si mësues definitiv.

Në lidhje me pretendimet e tij, ankuesi ka bërë ankesë pranë MASR, me nr. 68 prot, datë 07.01.2021 dhe trajtimi i kësaj ankesë është përcjellë pranë DRAP Lezhë me shkresën nr. 68/1 prot, datë 13.01.2021. Në lidhje me problematikën e profilit të edukimit fizik, ankesë kishte paraqitur edhe një kandidat tjetër i Portalit “Mësues për Shqipërinë” shtetasi B.V, i renditur i 4-ti.

Me urdhrin nr. 37, datë 26.01.2021 të Drejtorit të DRAP Lezhë është urdhëruar ngritja e grupit të inspektimit për verifikimin e ankesave të kandidatit B.V dhe shtetasit K.Sh, përfaqësues i ankuesit A.Sh. Bazuar në relacionin e datës 11.02.2021 të mbajtur nga grupi i inspektimit, ky i fundit ka relatuar se, nuk ka kryer inspektimin pasi, referuar relacioneve të DRAP Lezhe me nr. 2177/1 prot., datë 27.11.2020 dhe nr. 2282 prot datë 09.12.2020, për verifikimin e ankesës së një tjetër kandidati të Portalit profilit të edukimit fizik, në ZVAP Shkodër, ishin të vlefshme edhe për ankesat e shtetasve B.V dhe K.Sh, përfaqësuesi i ankuesit.

Nga aktet e administruara rezultoi se, në kuadër të verifikimit të ankesave që kishte bërë nga shtetasi I.G, kandidati i renditur i 1-ri në Portalin “Mësues për Shqipërinë” për vitin 2020-2021, DRAP Lezhë kishte kryer dy inspektime në shkollat në juridiksion të ZVAP Shkodër. Për të verifikuar pretendimet e ngritura prej këtij kandidati lidhur me mosshpalljen e vendeve vakante të profilit të edukimit fizik në juridiksion të ZVAP Shkodër, DRAP Lezhë ka kërkuar nga ZVAP

Shkodër dokumentacionin lidhur me Lëvizjen Paralele, vendet e lira të punës dhe ngarkesat mësimore të mësuesve të edukimit fizik për çdo institucion arsimor nën juridiksionin e ZVAP Shkodër. Bazuar në konkluzionet e inspektimeve të zhvilluara, rezulton se:

Sipas relacionit datë 27.11.2020, grupi i inspektimit të DRAP Lezhë, gjatë inspektimit të zhvilluar në ZVAP ka konstatuar se:

- Për vitin shkollor 2020-2021, lëvizja paralele në ZVAP Shkodër është zhvilluar më datë 11.08.2020. Një kandidat i profilit edukim fizik ka kryer lëvizje paralele me dëshirë konkretisht F. B., mësuese e shkollës 9-vjeçare “*Branko Kadia*”, e cila është emëruar në gjimnazim “*Oso Kuka*”.
- Në shkollën “*Branko Kadia*”, ishin 16 orë të lira të profilit edukim fizik.

Përsa më sipër, DRAP Lezhë, në përfundim të inspektimit të zhvilluar, ka rekomanduar që:

- Shkolla “*Branko Kadia*”, bazuar në Udhëzimin nr. 13, datë 22.05.2019 “*Për procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’*”, të dërgojë në ZVAP Shkodër, njoftim për shpalljen e 16 orëve të lira të lëndës edukim fizik.
- Shkolla “*Branko Kadia*”, të rishikojë shpërndarjen e ngarkesës mësimore të mësuesve sipas Udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2018 “*Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar*”.

Në vijim, DRAP Lezhë ka dërguar pranë DPAP-së dhe ZVAP-së Shkodër, relacionin nr. 2177/1 prot., datë 27.11.2020, me konkluzionet e sipërcituara.

Në inspektimin tjetër të zhvilluar nga DRAP Lezhë, referuar relacionit të datës 09.12.2020, grupi i konstatimit, ka konstatuar:

1. Në institucionin arsimor “*Salo Halili*”, dy mësuesit definitiv të profilit edukim fizik kanë përkatësisht 24 dhe 25 orë mësimore në javë secili, ose +2 dhe + 3 orë mbi normën e tyre. Pra, janë 5 orë të lira mësimore në profilin edukim fizik në shkollën “*Salo Halili*”.
2. Në institucionin arsimor “*Ndre Mjeda*”, 5 mësuesit definitiv të profilit edukim fizik kanë përkatësisht 22, 21, 24, 22, 22 orë mësimore. Si rezultat me 3 orët e profilit edukim fizik të shtuara në këtë situatë plotëson normën mësimore, mësuesi i profilit TIK megjithëse nuk janë profil i përafërt siç citohet në Udhëzimin Nr. 30, dt.12.08.2018, Kreu V- “*Të përgjithshme*”, pika 1.
3. Në institucionin arsimor “*Azem Hajdari*”, 2 mësuesit definitiv të profilit edukim fizik kanë përkatësisht nga 22 orë secili. Pra nuk ka orë të lira të profilit edukim fizik.
4. Institucioni arsimor “*Salo Halili*”, nuk kishte shpallur orët e lira sipas rekomandimit të DRAP Lezhë.

Përsa më sipër, DRAP Lezhë, në përfundim të inspektimit të zhvilluar, siç është pasqyruar edhe në relacionin datë 09.12.2020, ka rekomanduar që:

- Drejtoria e Shkollës “*Salo Halili*”, të rishikojë ngarkesën mësimore, duke u bazuar në Udhëzimin nr. 30, datë 12.09.2018 “*Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar*”, sipas shtojcës përkatëse të udhëzimit, pika 3, si dhe pika II/D Arsimit Bazë “*Norma mësimore javore e mësuesve dhe drejtuesve*”.
- Pas rishikimit të ngarkesës mësimore, në zbatim të Udhëzimit nr. 13, datë 22.05.2019 “*Për procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’*”, drejtoria e institucionit arsimor “*Salo Halili*” në bashkëpunim me ZVAP Shkodër, të bëjnë shpalljen e orëve të edukimit fizik të pambuluara me mësues të profilit dhe ato mbi normë.

Me relacionin nr. 2282 prot., datë 09.12.2020, DRAP Lezhë ka dërguar në DPAP dhe ZVAP Shkodër gjetjet e grupit të inspektimit të sipërcituar.

Nga provat e vëna në dispozicion nga palët në proces, rezultoi se ankuesit i janë ofruar, pozicionet e punës si më poshtë vijon:

1. ZVAP Shkodër me datë 09.12.2020 ka bërë shpalljen për vend të lirë pune, në profilin edukim fizik në shkollën “*9- Shtatori*”, Nj. Administrative Topojan, Kukës, shpallje e dërguar nga DRAP Lezhë. Ankuesi nuk ka kthyer përgjigje brenda 24 orëve siç parashikohet në kreun 4, pika 5 të Udhëzimit nr. 13/2019, i ndryshuar;
2. ZVAP Shkodër më datë 15.12.2020 ka bërë shpalljen për vend pune, në shkollën “*Haxhi Hajdari*”, Nj. Administrative Rrethina, Shkodër. Ankuesi, nuk ka kthyer përgjigje brenda 24 orëve siç parashikohet në kreun 4, pika 5 të Udhëzimit nr.13/2019, i ndryshuar;
3. ZVAP Shkodër me datë 08.01.2021 ka bërë shpalljen për vend pune, definitiv, në shkollën 1 Qershori dhe Havzi Nela, Kukës, shpallje dërguar nga DRAP Lezhë. Ankuesi, nuk ka kthyer përgjigje brenda 24 orëve siç parashikohet në kreun 4, pika 5 të Udhëzimit nr. 13/2019, i ndryshuar;
4. ZVAP Shkodër më datë 26.02.2021, ka shpallur një vend të lirë punë me afat, profili edukim fizik, në Shkollën 9-vjeçare “*Qazim Mehja*”, i cili është pranuar nga kandidati i parë i Portalit, I.G.

Ndërkohë ankuesi pretendoi se, përveç konstatimeve të mësipërme të kryera nga grupet e inspektimit të DRAP lezhë, sipas investigimeve që ai kishte kryer, ka orë të tjera të lira në

profilin e edukimit fizik, në institucionet arsimore në ZVAP Shkodër, të cilat nuk shpallen. Konkretisht përfaqësuesi i ankuesit pretendoi se, ka vende të lira në këto institucione arsimore: Shkolla “Adem Haxhija, Shkolla “Qazim Meja”, Shkolla “Ruzhdi Daca”, Shkolla “Xheladin Fishta”, Shkolla “Bardhaj”, Shkolla “Seit Tagani” Trush, Shkolla “Tringe Smajlaj” dhe “Sheldi” dhe Shkolla “Shejnaze Juka”. Ai pretendoi se informacioni që jepej nga institucionet arsimore ishte kontradiktor, duke raportuar ngarkesa të ndryshme të orëve mësimore në përgjigje të kërkesave të tij në raport me informacionin që kishin dërguar pranë ZVAP Shkodër.

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara, Komisioneri vlerëson se, në lidhje me orët e lira të profilit të edukimit fizik, për vitin mësimor 2020-2021, të konfirmuara rezultojnë orët e lira të konstatuara sipas inspektimeve të realizuara nga DRAP Lezhë. Në lidhje me pretendimet e ankuesit për mospërputhje midis informacionit që ai kishte marrë nga disa institucione arsimore dhe informacionit zyrtar që shkollat i kanë vendosur në dispozicion ZVAP Shkodër, Komisioneri vlerëson se kjo mospërputhje nuk provon pretendimet e ankuesit për orë të tjera të lira. Në lidhje me kontraditat në informacion, ankuesi duhet të shfrytëzojë mjetet e tjera të ankimit pranë institucioneve eprore që mbikëqyrin veprimtarinë e institucioneve arsimore.

Pranë Komisionerit, janë paraqitur për shqyrtim edhe ankesa të tjera, nga ana e kandidatëve të profilit të edukimit fizik, në ZVAP Shkodër dhe konkretisht, ankesa nr. 27, datë 23.02.2021, e paraqitur nga I.G, kandidati i renditur i 1-ri në Portalin 2020-2021 dhe ankesa nr. 26, datë 23.02.2021, e paraqitur nga kandidati B.V, i renditur i 4-ti, në të njëjtin portal.

Në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr. 27, datë 23.02.2021, Komisioneri ka zhvilluar seancën dëgjimore të datës 12.05.2021 dhe ka administruar deklaratimet e bëra nga përfaqësuesit e ZVAP Shkodër dhe DRAP Lezhë, në lidhje me mënyrën e pranimit dhe largimit të mësuesve në arsimin parauniversitar. Bazuar në informacionin e marrë gjatë seancës dëgjimore të sipërcituar, të administruar nga Komisioneri në kuadër të ushtrimit të funksioneve të tij, përfaqësuesit e këtyre institucioneve sqaruan se:

Përfaqësuesja e ZVAP Shkodër sqaroi se: *“ZVAP në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës në të cilën ka një vend vakant apo ka orë të lira, bëjnë publik në faqen elektronike zyrtare pozicionin e lirë të punës, së bashku me orët përkatëse. Për vitin shkollor 2020-2021, për shkak të rënies së numrit të nxënësve, është bërë një analizë e ngarkesës mësimore për mësuesit definitiv dhe ka rezultuar se në çdo profil kemi mësues tepër, pasi nuk plotësohen me ngarkesë të plotë mësimore. Bazuar në legjislacionin në fuqi, emërimi i një mësuesi bëhet nga drejtori i shkollës në të cilën ka orë të lira apo pozicion pune të lirë. Nuk ka kompetencë as ZVAP, as DRAP dhe as DPAP, të bëjë emërimin e mësuesve në një shkollë. ZVAP bën monitorimin e ngarkesës mësimore dhe shpërndarjes së saj nga ana e shkollave.*



*Në rastin e I.G, atij i janë ofruar nga ana e ZVAP-së Shkodër vende të lira pune me kontratë provizore, por janë refuzuar prej tij. Gjithashtu, duke qenë se nga ana e ZVAP Kukës është paraqitur një pozicion i lirë për mësues të Edukimit Fizik me kontratë pa afat, i është ofruar edhe I.G, por nuk është pranuar prej tij. Aktualisht ankuesi është i punësuar në shkollën ‘Qazim Mehja’, me ngarkesë mësimore 18 orë.*

*Lidhur me shkollën ‘Branko Kadia’, është e vërtetë që mësuesja e sistemit ka bërë lëvizje paralele dhe ka shkuar në shkollën ‘Oso Kuka’, por për shkak të pandemisë në këtë shkollë nuk ka orë të lira të profilit Edukim Fizik, pasi janë shkurtuar orët nga 45 minuta në 30 minuta. Në rast se do të dalim nga skenarët e zhvillimit të mësimi si pasojë e situatës së pandemisë, atëherë në shkollën ‘Branko Kadia’, do të ketë 16 orë të lira. Pra, aktualisht në këtë shkollë nuk ka orë të lira të profilit Edukim Fizik.*

*Për të punësuar një mësues me kontratë pa afat, nevojitet që ai të plotësohet me normë të plotë mësimore, 22 orë, të shpërndara në një ose më shumë shkolla, por këto orë të mos rrezikojnë që në vitin e ardhshëm shkollor të reduktohen. Ndëkaq, profili i Edukimit Fizik, nuk ka orë të lira në ZVAP Shkodër. Edhe nëse një kandidat plotësohet me normë të plotë për këtë vit shkollor, rrezikon që në vitin pasardhës të mbetet sërish pa ngarkesë, pasi në shkollat e ZVAP Shkodër nga viti shkollor 2016-2017 deri në vitin 2020-2021, ka një rënie të theksuar të numrit të nxënësve prej rreth 1800. Vetëm duke krahasuar vitin shkollor 2019-2020 me 2020-2021, ka një rënie të numrit të nxënësve me rreth 800 nxënës.*

*Në profile të tjera si: Muzikë apo Art Pamor, kemi mungesë të mësuesve dhe janë shpallur vende të lira me kontratë pa afat. Pra në rastin e ankuesit, pavarësiht nëse mund t’i plotësohet ngarkesa mësimore e plotë, nuk mund ta punësojmë me kontratë pa afat në kushtet në të cilat ndodhemi.”*

*Nga DRAP Lezhë, u sqarua ndër të tjera se: “Bazuar në ankesat e I.G dhe të disa kandidatëve të tjerë, DRAP Lezhë ka ngritur një grup pune për të analizuar ngarkesat mësimore të Edukimit Fizik në shkollat e ZVAP-së Shkodër. Është verifikuar ngarkesa mësimore në disa shkolla dhe është dalë me një relacion, ku është konstatuar se në shkollën ‘Branko Kadia’, si me pandemi dhe pa pandemi janë 16 orë të lira pune, në profilin e Edukimit Fizik, ndryshe nga gfarë pretendon ZVAP Shkodër dhe drejtoresha e kësaj shkolle. Pas konstatimeve të bëra, DRAP Lezhë ka dërguar për zbatim pranë ZVAP-së Shkodër gjetjet e grupit të inspektimit. Nga DRAP Lezhë është rekomanduar shpallja e orëve të lira në shkollën ‘Branko Kadia’, por nuk janë shpallur nga ana e ZVAP-së dhe drejtueses së kësaj shkolle. Arsyeimi sipas drejtoreshës së shkollës ‘Branko Kadia’, sa i përket mos shpalljes së orëve të Edukimit Fizik, kishte të bënte me faktin se duhen mbrojtur mësuesit e sistemit dhe kjo ngarkesë i duhej shpërndarë atyre. Gjithashtu, kishte kërkuar në ZVAP Shkodër, të mos shpallen këto orë të lira. Pra, sipas nesh ka një paqartësi nga*



*ana e drejtueses së shkollës në zbatimin e skenarëve të pandemisë dhe zbatimit të udhëzimeve sa i përket shpërndarjes së ngarkesës mësimore.*

*DRAP Lezhë ka nën juridiksionin e saj 10 ZVAP, të cilat janë: Shkodra, Lezha, Vau i Dejës, Malësia e Madhe, Kurbini, Kukësi, Mirdita, Hasi, Fushë Arrëz dhe Tropojë. Kandidatët që konkurojnë në portalin 'Mësues për Shqipërinë', marrin pjesë dhe zgjedhin 3 ZVAP për të konkuruar. Për të gjitha vendet e lira që hapen në këto 3 ZVAP, kandidati i renditur i pari në portal njoftohet për këtë vend. Në rast se, kandidati i renditur i pari nuk pranon të emërohet në këtë pozicion pune ose nuk kthen përgjigje brenda një afati prej 24 orësh, atëherë sipas renditjes njoftohen me rradhë kandidatët e tjerë pas tij, deri në momentin që të ezaurohet e gjithë lista e kandidatëve. Ndërkaq, nëse një ZVAP bën publik një pozicion pune dhe nuk gjen kandidat për këtë pozicion, atëherë njofton DRAP-in, i cili më pas ua përcjellë të gjithë ZVAP-ve të tjera që ka nën juridiksion, nëse ka ndonjë kandidat që do të pranojë emërimin në këtë pozicion të lirë pune. E njëjta situatë është paraqitur edhe për ankuesin në momentin që i është ofruar pozicionin i lirë me kontratë pa afat në një nga shkollat e ZVAP Kukës, në profilin Edukim Fizik."*

Sa më sipër rezulton se, ofrimi i vendeve të punës që janë në juridiksionin e një tjetër ZVAP-je, është një praktikë që ndiqet në rastet kur në ZVAP-në respektive nuk ka kandidatë dhe nuk është një praktikë që është zbatuar nga ZVAP Shkodër vetëm në rastin e ankuesit.

Pra, referuar legjislacionit të sipërcituar dhe interpretimit të bërë nga ana e ZVAP Shkodër dhe DRAP Lezhë, për të punësuar një mësues me kontratë pa afat të caktuar, nevojitet që ai të plotësohet me normë të plotë mësimore, 22 orë, të shpërndara në një ose më shumë shkolla, por këto orë të mos rrezikojnë që në vitin e ardhshëm shkollor të reduktohen. Ndërkaq, sipas provave të vëna në dispozicion, profili i edukimit fizik, nuk ka orë të lira në ZVAP Shkodër, përveç atyre të konstatuara nga inspektimet e DRAP Lezhë. Gjithashtu, referuar të dhënave të vendosura në dispozicion nga ZVAP Shkodër, me shkresën nr. 966 prot., datë 11.05.2021, rezulton se, nga viti shkollor 2016-2017 deri në vitin 2020-2021, ka një rënie të theksuar të numrit të nxënësve prej rreth 1800. Duke krahasuar vitin shkollor 2019-2020 me 2020-2021, ka një rënie të numrit të nxënësve me rreth 800 nxënës. Në këtë kuadër, rënia e numrit të nxënësve nga viti në vit, është një tregues që jep indicie se orët për vitin e ardhshëm shkollor kanë rrezik të reduktohen, duke përfshirë këtu edhe orët për profilin e edukimit fizik, si për të gjitha profilet e tjera.

Në përfundim, Komisioneri gjatë analizës së informacionit dhe provave të sipërcituara, konstatoi se:

- Pavarësisht faktit që nga ana e ZVAP Shkodër apo institucioneve arsimore nën juridiksionin e saj, nuk janë shpallur një pjesë e orëve të lira të profilit të edukimit fizik, nuk u konstatua që ky veprim apo mosveprim i tyre të jetë bërë me qëllim përjashtimin e ankuesit nga e drejta për t'u punësuar. Një fakt i tillë del qartësisht edhe nga vetë pretendimet e ankuesit të cilat i ka parashtruar në ankesën e depozituar pranë MASR nr.

68 prot, datë 07.01.2021, në të cilën ai shprehet se, gjatë vitit shkollor 2019-2020, ka qenë falë ankesave të tij që janë shpallur vendet e punës dhe janë punësuar 4 kandidatët e parë të Portalit të këtij viti mësimor. Përpara Komisionerit, përfaqësuesi i ankuesit pretendoi se diskriminimi i ankuesit ishte pasojë e një sërë paligjshmërive, veprimeve dhe mosveprimeve nga ana e institucioneve arsimore dhe ZVAP Shkollës të ndodhura vite më parë. Të gjitha këto veprime të shtrira në një kohë kaq të gjatë (duke filluar sipas përfaqësuesit të ankuesit që nga 2016-2017) dhe të kryera nga institucione të ndryshme arsimore, nuk krijojnë dyshime se ato janë bërë me qëllimin për të mos lejuar punësimin e ankuesit;

- Nga ana tjetër, ankuesi ka qenë i punësuar gjatë vitit mësimor 2019-2020 dhe ZVAP Shkodër, i ka ofruar disa mundësi punësimi gjatë vitit 2020-2021, të cilat i ka refuzuar;
- Nuk rezultoi, që të jetë punësuar një mësues tjetër i profilit të edukimit fizik me kontratë me afat të caktuar ose jo, përpara se t'i ofroheshin këto mundësi ankuesit;
- Nuk rezultoi se në ZVAP Shkodër apo DRAP Lezhë, të kishte pozicione të lira të profilit edukim fizik dhe të mos i ofroheshin ankuesit.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi.”*

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Përsa më sipër, pavarësisht nëse ZVAP Shkodër dhe institucionet arsimore nën juridiksionin e saj, mund të kenë kryer shkelje lidhur me moszbatimin korrekt të akteve nënligjore të sipërcituara, duke mos shpallur një pjesë të orëve lira të profilit të edukimit fizik, kjo situatë nuk ka vënë në pozita të pabarabarta apo të pafavorshme në raport me të tjerë.

Në mungesë të një trajtimi të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e DRAP Lezhë dhe ZVAP Shkodër, për shkakun e pretenduar nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se këto ato kanë shkelur dispozitat e ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

## **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit A.Sh, në të drejtën për punësim, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Shkodër, për shkakun e pretenduar prej tij.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Shkaku : Bindjet politike  
Fusha : Punësim  
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim